



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA LIBRAZHD
Drejtoria e Burimeve Njerëzore

SHPALLJE
PËR LEVIZJE PARALELE NGRITJE NË DETYRË, PRANIM NGA JASHT
SHËRBIMIT CIVIL NË KATEGORINË E MESME DREJTUESE (Drejtor)

Lloji i diplomës , Master Shkencor në Shkencat, e Inxhinierisë së Ndërtimit, Arkitekturë .

Në zbatim të ligjit 152/2013, “Për nëpunësin civil ” i ndryshuar, neni 22 neni 25, si dhe të Kreut II, III, IV dhe VII, të Vendimit të Këshillit të Ministrave , Nr. 243, datë 18/03/2015, Bashkia Librazhd shpall procedurën e levizjes paralele, të ngritjes në detyrë dhe të pranimit nga jashtë shërbimit civil, për kategorinë e mesme drejtuese .(Të tria procedurat zhvillohen në të njëjtën kohë).

- **1 (një) vënd në pozicionin, Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit, Kontrollit të Teritorit dhe Pronës – Kategori II – 2.**

Shpallja është e hapur për të gjithë nëpunësit civilë brënda të njëjtës kategori në të gjitha institucionet pjesë e shërbimit civil për procedurën e levizjes paralele. Vetëm në rast se ky pozicion, në përfundim të procedurës së levizjes paralele rezulton vakant, ai është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë dhe pranimit nga jashtë shërbimit civil. **Për të tre procedurat (lëvizje paralele, ngritjen në detyrë dhe pranim nga jashtë shërbimit civil në kategorinë e mesme drejtuese) aplikohet në të njëjtën kohë.**

Afati i dorëzimit të dokumentave për :

Levizje paralele :10.09.2025

Afati i dorëzimit të dokumentave për :

Ngritje në detyrë :15.09.2025

Afati i dorëzimit të dokumentave për:

Pranimin nga jashtë shërbimit civil: 15.09.2025

Përshkrimi i përgjithsues i punës për pozicionin e mësipërm është :

- 1 . Përfaqëson drejtorinë në mardhënie me sektorë të ndryshëm në bashki, institucione të ndryshme shtetërore apo vendore.
2. Ndjek zbatimin e detyrave të ngarkuara në lidhje me disiplinimin urban të qytetit.
- 3 .Organizon punë studimore dhe propozon masa konkrete, gjatë hartimit të instrumentave vendore të planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit të teritorit.
- 4 . Informon në mënyrë periodike eprorin direkt për problemet e ndryshme në lidhje me zbatimin e legjislacionit në fushën e planifikimit të teritorit.
5. Ndjek realizimin e detyrave të dhëna nga eprori direkt dhe raporton për shkallën, nivelin dhe cilësinë e realizimit të tyre.
- 6 . Kërkon llogari nga vartësit për rrespektimin e disiplinës në punë si dhe për realizimin e detyrave funksionale të tyre.
7. Bën vlersimin vjetor të punës së vartësve dhe i propozon kryetarit të bashkisë masa disiplinore, kur këta të fundit shfaqin paaftësi në kryerjen e detyrës ose shkelin rëndë disiplinën në punë .
8. Studion dhe i'u jep zgjidhje problemeve që dalin gjatë ndërtimit të rrjetit inxhinierik apo gjatë kryerjes së punimeve për ndërtimin e rrugëve, trotuareve, rrjeteve të kanlizimit të ujrave të bardha apo të ndotura, shtrirjes së linjave elektrike apo telefonike etj.
9. Kordinon punën me drejtorinë e punëve publike pranë bashkisë, për hartimin e projekteve për përmirësimin e infrastrukturës së qytetit, kryerjen e investimeve publike me financime të brëndshme buxhetore, apo të huaja.
10. Kontrollon çmimet e preventivave të objekteve publike dhe private të paraqitura për miratim në drejtorinë e planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit të teritorit.
11. Ndjek vazhdimisht në terren procesin e zbatimit të projekteve gjatë fazës së ndërtimit të strukturave, duke sqaruar, e i'u dhënë zgjidhje, problemeve që dalin gjatë realizimit të ndërtimit në bashkëpunim me mbikqyrësit e punimeve.
- 12.Kontrollon dokumentacionin teknik në lidhje me infrastrukturën inxhinierike.
13. Bashkërendon punën ndërsektoriale brënda drejtorisë së planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit të teritorit.
14. Në bazë të kërkesave të subjekteve ndërtuese, për tu paisur me leje përdorimi, kryen kontrollin përfundimtar të objektit dhe përgatit materialin përkatës për shqyrtim e miratim.
15. Përditëson në mënyrë periodike, në hartë dhe rregjistër, të gjitha objektet e paisur me leje ndërtimi.
16. Kontrollon dhe është përgjegjës për genplanet e azhornimit, të përgatitura nga specialistët e bashkisë apo të subjekteve private.
17. Arkivon të gjitha materialet e sistemuara në dosje në momentin kur merren dokumentet nga të interesuarit për leje zhvillimi dhe leje ndërtimi.
18. Nxjerr dhe fotokopjon materialet e dosjeve që kërkohen për konfirmim e vërtetim me origjinalin.

1. LEVIZJA PARALELE

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit e të njëjtës kategori, në të gjitha institucionet pjesë e shërbimit civil

1.1 . Kushtet për levizjen paralele dhe kriteret e veçanta :

- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar për kategorinë për të cilën aplikon;
- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- Të ketë të paktën një vlerësim pozitiv “mire” apo “shumë mire”;
- Të ketë eksperiencë 5 vjetecare në punë;
- Arsim i lartë, Master Shkencor në Shkencat Inxhinieri Ndërtimi, Arkitekturë, Urbanist.
- Të ketë njohuri të mira kompjuterike të programeve bazë Excel dhe Word;
- Të njohë mirë gjuhë të huaja (mbrojtja përbën avantazh);
- Të plotësojë kriteret e veçanta të përcaktuara në njoftimin për konkurim.

1.2 . Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit

Kandidati duhet të dërgojë me postë ose dorazi në zarf të mbyllur, në Njësinë e Burimeve Njerëzore të Bashkisë Librazhd, dokumentet e dosjes së tij personale si me poshte:

- Letër motivimi për aplikim në vëndin vakant;
- Një kopje të jetëshkrimit;
- Një numër kontakti dhe adresën e plotë të vëndbanimit;
- Fotokopjen e noterizuar të diplomës dhe listës së notave. Nëse aplikanti disponon një diplomë të një Universiteti të huaj, atëherë ai duhet ta ketë atë të njohuar pranë Ministrisë përgjegjëse për Arsimin;
- Fotokopje të listës së notave. Nëse ka një diplomë dhe një listë notash të ndryshme me vlerësimin e njohur në shtetin Shqiptar, atëherë aplikanti duhet ta ketë atë të konvertuar sipas sistemit shqiptar;
- Fotokopje e librezës së punës së plotësuar;
- Vërtetim i gjëndjes gjyqësore;
- Fotokopjen e Aktit të emërimit si nëpunës civil për kategorinë për të cilën konkuron;
- Fotokopje të një vlerësimi vjetor;
- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- Vërtetim nga punëdhënësi i fundit që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- Fotokopje të certifikatave të ndryshme të kualifikimeve dhe trajnimeve të ndryshme që disponon aplikanti;
- Fotokopje e kartës së identitetit;

Ky dokumentacion duhet të dorëzohet nga kandidati me postë ose drejtpërdrejt në Njësinë e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, Bashkia Librazhd deri në datën **10/09/2025**.

1.3. Rezultatet e verifikimit paraprak të kandidatëve

Rezultatet e verifikimit paraprak do të dalin në datën **12/09/2025** nëpërmjet shpalljes së listës emerore të kandidateve që do të vazhdojnë konkurimin, në portalin "Shërbimi Kombëtar i Punësimit" dhe në stendën e informimit të bashkisë.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, për shkaqet e moskualifikimit (nëpërmjet adresës së e-mail).

Ankesat nga kandidatët paraqiten në Njësinë e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, brënda 3 ditëve pune nga shpallja e listës dhe ankuesi merr përgjigje brënda 3 diteve pune nga data e depozitimit të ankesës .

1.4.. Fushat e njohurive, aftësive dhe cilësive mbi të cilat do të zhvillohet intervista

Në intervistë kandidatët do të vleresohen për njohuritë e tyre në këto fusha:

- Njohuri për Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë;
- Ligjin Nr. 152/2013 "Për nepunesin civil" i ndryshuar dhe aktet nenligjore për zbatimin e tij;
- Ligjin Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" ;
- Ligjin Nr. 9131 datë 08.09.2003 "Për rregullat e etikës në administratën publike" ;
- Ligjin Nr. 119/2014, "Për të drejtën e informimit"
- Ligjit nr.107/2014 "Për planifikimin e teritorit ".
- Ligjit nr.9780 datë 16.07.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e teritorit nga ndërtimet e kundraligjshme ".
- Ligjin nr.8402 datë 10.09.1998 " Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve në ndërtim " i ndryshuar.
- VKM nr. 408 datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të teritorit " .
- VKM nr.232 datë 17.04.2019 "Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr.686 datë 22.11.2017 "Për miratimin e rregullores së planifikimit të teritorit ".

1.5. Mënyra e vlerësimit të kandidateve

Nëpërmjet dokumentacionit dhe intervistës së strukturuar me gojë.

Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është 100 pikë të cilat ndahen përkatësisht:

- a. 40 pikë për dokumentacionin e dorëzuar i ndarë si më poshtë:
 - 10 pikë për kualifikimet e lidhura me fushën përkatëse;
 - 20 pike për eksperiencën në punë
 - 10 pikë për vlerësimet pozitive.

- b. 60 pikë për intervistën e strukturuar me gojë, ku do intervistohet për;
- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
 - Eksperiencën e tyre të mëparshme;
 - Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën

Kandidati që merr më pak se 70 pikë nuk konsiderohet i suksesshëm.

1.6. Data e daljes së rrezultateve të konkurimit dhe mënyra e komunikimit

Kandidati që merr më pak se 70 pikë nuk konsiderohet i suksesshëm.

Shpallja e fituesit do të bëhet në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në stendën e informimit të Bashkisë Librazhd.

2. NGRITJA NË DETYRË

Nëse në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele nuk ka fitues, plotësimi i vëndit vakant do të realizohet nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë në shërbimin civil në kategorinë e mesme drejtuese. Këtë informacion do ta merrni në faqen zyrtare të bashkisë duke filluar nga data **25.09.2025**.

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë vetëm nëpunës civilë të një kategorie paraardhëse, (vetëm një kategori më e ulët) , nga të gjitha institucionet pjesë e shërbimit civil që plotësojnë kushtet minimale për ngritjen në detyrë dhe kërkesat e posaçme për vëndin e lirë të punës.

2.1. Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e ngritjes në detyrë në shërbimin civil dhe kriteret e veçanta

Kushtet që duhet të plotësojnë kandidatët për ngritjen në detyrë:

- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar, kategoria e ulët drejtuese.
- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas ligjit nr. 152/2013 i ndryshuar.

Kriteret e veçanta për këtë pozicion janë:

- Të zotërojë diplomë të nivelit, “ Master Shkencor ” në Shkencat Inxhinieri Ndërtimi, Arkitekturë etj. Edhe diploma e nivelit “Bachelor” duhet të jetë në të njëjtën fushë.
- Eksperienca në punë përbën avantazh.

2.2. Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit

Kandidatët duhet të dërgojnë me postë ose dorazi në Njësinë e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, Bashkia Librazhd, këto dokumente:

- Letër motivimi për aplikim në vendin vakant;
- Një kopje të jetëshkrimit;
- Një numër kontakti, adresë aktive e-maili dhe adresën e plotë të vendbanimit;
- Fotokopje e noterizuar e diplomës dhe listës së notave (nëse aplikanti disponon një diplomë të një universiteti të huaj, duhet ta ketë të njësuar pranë Ministrisë së Arsimit);
- Fotokopje e listës së notave (nëse ka një listë notash të ndryshme me vlerësimin e njohur në Shtetin Shqiptar, aplikanti duhet ta ketë të konvertuar atë sipas sistemit shqiptar);
- Fotokopje e librezës së punës e plotësuar;
- Vërtetimi i gjendjes gjyqësore;
- Vërtetim i gjendjes shëndetësore;
- Fotokopje të kartës së identitetit.
- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt.
- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton, trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

Dokumentet e mësipërme duhet të dorëzohen deri më datë **15/09/2025** me postë ose në Njësinë e Burimeve Njerëzore pranë Bashkisë Librazhd.

2.3. Rezultatet e verifikimit paraprak të kandidatëve

Lista paraprake e verifikimit të kandidatëve që plotësojnë kërkesat e përgjithshme për ngritjen në detyrë në shërbimin civil dhe kriteret e veçanta të pozicionit të punës do të shpallen në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në stendën e informimit të publikut më datë **25.09.2025**. Gjithashtu, po në këtë datë, kandidatët që nuk janë kualifikuar do të njoftohen nga Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore për shkaqet e moskualifikimit, personalisht nëpërmjet adresës së e-mail.

2.4. Fushat e njohurive, aftësitë dhe cilësitë mbi të cilat do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista.

Konkurrimi do të bazohet në njohuritë e kandidatëve mbi:

- Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë;
- Ligjin Nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar;
- Kodin e Procedurave Administrative;
- Ligjin Nr. 139/2015, “Per Vetëqeverisjen Vendore” ;

- Kodin e Punës së Republikës së Shqipërisë ;
- Ligjin Nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit” ;
- Ligjit nr.107/2014 “Për planifikimin e teritorit “.
- Ligjit nr.9780 datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e teritorit nga ndërtimet e kundraligjeshme “.
- Ligjin nr.8402 datë 10.09.1998 “ Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve në ndërtim “ i ndryshuar .
- VKM nr. 408 datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të teritorit “ .
- VKM nr.232 datë 17.04.2019 “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr.686 datë 22.11.2017 “Për miratimin e rregullores së planifikimit të teritorit “.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me :

- Njohuritë, aftësitë, kooptencën në lidhje me përshkrimin përgjithësues të punës , për pozicionet.
- Eksperienën e tyre të mëparshme .
- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën

2.5. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve

Kandidatët do të vlerësohen nga Komiteti i Përhershëm i Pranimit, i ngritur pranë Bashkisë Librazhd.

Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është 100, të cilat ndahen përkatësisht:

- për vlerësimin e jetëshkrimit (CV) të kandidatëve, që konsiston në vlerësimin e arsimimit (mesataria kriter vlerësues), të eksperiencës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, si dhe vlerësimet e arritjeve vjetore, 15 pikë;
- për intervistën e strukturuar me gojë, 25 pikë;
- për vlerësimin me shkrim, 60 pikë.

Komiteti i Përhershëm i Pranimit, në përfundim të fazës së vlerësimit të kandidatëve, liston kandidatët fitues me mbi 70 pikë (mbi 70 % të pikëve), duke filluar nga kandidati me rezultatin më të lartë.

2.6. Data e daljes së rrezultateve të konkurimit dhe mënyra e komunikimit

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, bashkia do të shpallë fituesin në faqen zyrtare dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit “.

Njoftimi dhe komunikimi me kandidatët do të jetë nëpërmjet telefonit dhe adresës së email të kandidatit.

Vetëm në rast se pozicioni i renditur në fillim të kësajë shpallje, në përfundim të procedurës së ngritjes në detyrë, rezulton se është ende vënd vakant, ai është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimit nga jashtë shërbimit civil.

Këtë informacion do ta merni në faqen zyrtare të bashkisë Librazhd duke filluar nga data **25.09.2025**.

3. PRANIMI NGA JASHTË SHËRBIMIT CIVIL

Vetëm në rast se pozicioni i renditur në fillim të kësajë shpallje, në përfundim të procedurës së ngritjes në detyrë, rezulton se është ende vënd vakant, ai është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimit nga jashtë shërbimit civil.

Këtë informacion do ta merni në faqen zyrtare të bashkisë Librazhd duke filluar nga data **25.09.2025**.

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë edhe kandidatë të tjerë nga jashtë shërbimit civil, që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e veçanta për vëndin e lirë.

3.1.Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e pranimit nga jashtë shërbimit civil

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë edhe kandidatë të tjerë nga jashtë shërbimit civil, që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e veçanta për vëndin e lirë.

a. Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e ngritjes në detyrë ;

- Të jetë shtetas shqiptar ;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar ;
- Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas ligjit nr. 152/2013 i ndryshuar (dokument nga institucioni);
- Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryej detyrën përkatëse;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtje penale me dashje ;

b. Kërkesat e posaçme për pozicionin Drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë dhe Ushqimit janë si më poshtë ;

- Të zotërojë diplomë të nivelit Master Shkencor(ose të barazvlefshme), në shkencat Inxhinieri Ndërtimi, Arkitekturë,et. Diploma e nivelit Bachelor duhet të jetë e të njëjtës fushë ;

- Të ketë të paktën 5 (Pesë) vite eksperiencë pune në profesion;
- Të ketë aftësi të mira profesionale, organizative, etikë të lartë në komunikim dhe aftësi të mira pune në grup;

3.2.Dokumentacioni, Mënyra dhe Afati i Dorëzimit.

- Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentain tip që e gjeni në linkun ; <http://ëëë.dap.gov.al/legislacioni/udhëzime-manuale/> 60-jetëshkrimi standard ;
- Fotokopje e noterizuar e diplomës dhe listës së notave (përfshirë edhe diplomën Bachelor).Nëse aplikanti disponon një diplomë të një Universiteti të huaj, atëhere ai duhet ta ketë atë të njehsuar pranë Ministrisë së Arsimit;
- Fotokopje e librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- Fotokopje e kartës së identitetit (ID) ;
- Vërtetim të gjendjes shëndetësore ;
- Vërtetim i gjendjes gjyqësore;
- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- Vërtetim nga punëdhënësi i fundit që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- Fotokopje të certifikatave të ndryshme të kualifikimeve dhe trajnimeve të ndryshme që disponon aplikanti;

Aplikimi dhe dorëzimi i dokumentave për procedurën e pranimit nga jashtë shërbimit civil duhet të bëhet, brenda datës **15.09.2025**, me postë në Adresën Bashkia Librazhd, Lagja nr.1 Sheshi “ Gjergj Arjaniti “ Librazhd ose në Njësinë e Burimeve Njerzore një kopje të dokumentave të mëposhtëme ;

3.3 . REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **25.09.2025** bashkia Librazhd do të shpallë në faqen zyrtare dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit “ listën e kandidatëve që plotësojnë kriteret e veçanta për procedurën e pranimit nga jashtë shërbimit civil si dhe datën, vëndin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kriteret e veçanta për procedurën e pranimit nga jashtë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga burimet njerzore.

3.4.Fushat e Njohurive, Aftësitë dhe Cilësitë mbi të Cilat do të Zhvillohet testimi dhe Intervista.

Kandidatët në **testin me shkrim**, do të vlerësohen në lidhje me njohuritë mbi;

- Njohuri për Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë;
- Ligjin Nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar dhe aktet nënligjore për zbatimin e tij;

- Ligjin Nr. 139/2015”Per vetëqeverisjen vendore” ;
- Ligjin Nr. 9131 date 08.09.2003”Për rregullat e etikës në administratën publike” ;
- Ligjin Nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”
- Ligjit nr.107/2014 “Për planifikimin e teritorit “.
- Ligjit nr.9780 datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e teritorit nga ndërtimet e kundraligjeshme “.
- Ligjin nr.8402 datë 10.09.1998 “ Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve në ndërtim “ i ndryshuar .
- VKM nr. 408 datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të teritorit “.
- VKM nr.232 datë 17.04.2019 “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr.686 datë 22.11.2017 “Për miratimin e rregullores së planifikimit të teritorit”.

Kandidatët gjatë intervistës së **strukturuar me gojë** do të vlerësohen në lidhje me;

Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës, eksperiencë e tyre të mëparshme, motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

3.5. Mënyra e Vlerësimit të Kandidatëve:

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me ;

- Jetëshkrimin, ku përfshihen arsimi, përvoja në punë, trajnimet apo kualifikimet të lidhura me fushën (deri në 20 pikë) ;
- Vlerësimin e testimit me shkrim (40 pikë);
- Vlerësimi i intervistës së strukturuar me gojë, që konsiston në motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë për karrierën (40 pikë) ;

3.6.Data e Daljes së rrezultateve të Konkurimit dhe Mënyra e Konkurimit.

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve , bashkia Librazhd do ti njoftojë ata individualisht në mënyrë elektronike për rrezultatet .

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e pranimi nga jashtë, do të marrin informacion në faqen e bashkisë Librazhd për fazat e mëtejshme të kësajë procedure ;

- Për datën e daljes së rrezultateve të verifikimit paraprak.
- Datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi ;

Për të marrë këtë informacion, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme faqen e bashkisë Librazhd duke filluar nga data **25.09.2025**.